



**KODI I ETIKËS DHE DEONTOLOGJISË  
I PSIKOLOGËVE NË REPUBLIKËN E  
SHQIPËRISË**

**MAJ 2017**

## Tabela e përmbajtjes

Njohja dhe zbatueshmëria .....	5
Parathënie .....	6
Parimet e përgjithshme .....	6
Parimi A: Përfitimi dhe mosdëmtimi .....	6
Parimi B: Besnikëria dhe përgjegjësia .....	7
Parimi C: Integriteti .....	7
Parimi D: Drejtësia .....	7
Parimi E: Respekt për dinjitetin dhe të drejtat e njeriut .....	7
Kreu 1: Zgjidhja e çështjeve etike .....	8
1.01 Keqpërdorimi i punës së psikologut .....	8
1.02 Konfliktet ndërmjet etikës, ligjit, rregulloreve ose një autoriteti tjetër ligjor rregullues .....	8
1.03 Konfliktet ndërmjet etikës dhe kërkesave organizative .....	8
1.04 Zgjidhja jozyrtare për shkeljet etike .....	8
1.05 Raportimi i shkeljeve të etikës .....	8
1.06 Bashkëpunimi me komisionet e etikës .....	9
1.07 Ankesat e papërshtatshme .....	9
1.08 Diskriminimi i padrejtë kundrejt ankuesve dhe të paditurve .....	9
Kreu 2 Kompetenca .....	9
2.01 Kufijtë e kompetencës .....	9
2.02 Ofrimi i shërbimeve në kushte emergjence .....	10
2.03 Ruajtja e kompetencave .....	10
2.04 Bazat për gjykimet shkencore dhe profesionale .....	10
2.05 Delegimi i punës te të tjerët .....	10
2.06 Problemet personale dhe konfliktet .....	10
Kreu 3: Marrëdhëniet njerëzore .....	11
3.01 Diskriminimi i padrejtë .....	11
3.02 Ngacmimi seksual .....	11
3.03 Ngacmime të tjera .....	11
3.04 Shmangia e dëmtimit .....	11
3.05 Marrëdhëniet e shumëfishta .....	11
3.06 Konflikti i interesit .....	12
3.07 Kërkesa për shërbim nga palët e treta .....	12
3.08 Marrëdhëniet shfrytëzuese .....	12
3.09 Bashkëpunimi me profesionistë të tjerë .....	12
3.10 Miratimi i informuar .....	12

3.11 Shërbimet psikologjike për organizatat ose nëpërmjet organizatave.....	13
3.12 Ndërprerja e shërbimit psikologjik .....	13
Kreu 4: Konfidencialiteti dhe privatësia .....	13
4.01 Ruajtja e konfidencialitetit.....	13
4.02 Njoftimi për kufizimet e konfidencialitetit.....	14
4.03 Regjistrimi .....	14
4.04 Minimizimi i ndërhyrjes në privatësi .....	14
4.05 Zbulimi i informacioneve identifikuese .....	14
4.06 Konsultimet .....	14
4.07 Përdorimi i informacioneve konfidenciale për qëllime didaktike ose për qëllime të tjera.....	15
Kreu 5. Reklama dhe deklaratat të tjera publike.....	15
5.01 Shmangia e deklaratave të pavërteta ose keqorientuese .....	15
5.02 Deklarata nga të tjerë .....	15
5.03 Përshkrimi i kurseve dhe programeve të edukimit që nuk ofrojnë grada .....	16
5.04 Prezantimet në media.....	16
5.05 Dëshmitarët .....	16
5.06 Kërkesat personale .....	16
Kreu 6. Mirëmbajtja e të dhënave dhe tarifimi .....	16
6.01 Dokumentimi i punës shkencore dhe profesionale dhe mirëmbajtja e të dhënave ..	16
6.02 Mirëmbajtja, shpërndarja dhe asgjësimi i të dhënave konfidenciale të punës profesionale dhe shkencore.....	17
6.03 Refuzimi i dhënies së informacionit për shkak të moskryerjes së pagesës .....	17
6.04 Tarifat dhe marrëveshjet financiare .....	17
6.05 Shkëmbimet <i>klering</i> me klientët/pacientët .....	18
6.06 Përpikmëria në raportet ndaj paguesit dhe burimeve të financimit .....	18
6.07 Referimet dhe tarifat .....	18
Kreu 7. Edukimi dhe trajnimi .....	18
7.01 Hartimi i programeve të edukimit dhe trajnimit .....	18
7.02 Përshkrimi i programit të edukimit dhe trajnimit.....	18
7.03 Saktësia në mësimdhënie.....	18
7.04 Zbulimi i informacionit personal të studentit .....	19
7.05 Terapia e detyrueshme individuale ose në grup .....	19
7.06 Vlerësimi i performancës së studentëve dhe i personave nën supervizim .....	19
7.07 Marrëdhëniet seksuale me studentët dhe personat nën supervizim .....	19
Kreu 8. Kërkimet dhe publikimet .....	19
8.01 Miratimi institucional .....	19
8.02 Miratimi i informuar për kërkimin shkencor.....	19

8.03 Miratimi i informuar për regjistrimin e zërave dhe imazheve në studim .....	20
8.04 Klientët/pacientët, studentët dhe vartësit, si pjesëmarrës në studim.....	20
8.05 Shpërndarja e informacionit të studimit pas miratimit të informuar .....	20
8.06 Ofrimi i stimujve për pjesëmarrje në studim.....	21
8.07 Manipulimi në kërkimin shkencor .....	21
8.08 Informimi.....	21
8.09 Kujdesi njerëzor dhe përdorimi i kafshëve në studim .....	21
8.10 Raportimi i të dhënave të studimit .....	21
8.11 Plagjiatura.....	22
8.12 Merita e publikimit .....	22
8.13 Publikimi i dyfishtë i të dhënave.....	22
8.14 Ndarja/dhënia/dorëzimi i të dhënave kërkimore për verifikim .....	22
8.15 Rishikuesit/Shqyrtuesit/Reçensuesit .....	22
Kreu 9. Vlerësimi .....	22
9.01 Bazat e vlerësimit.....	22
9.02 Përdorimi i vlerësimeve.....	23
9.03 Marrja e miratimit të informuar në vlerësim .....	23
9.04 Nxjerrja e të dhënave të testit.....	24
9.05 Ndërtimi i testit .....	24
9.06 Interpretimi i rezultateve të vlerësimit.....	24
9.07 Vlerësimi nga persona të pakualifikuar .....	24
9.08 Testet e vjetëruara dhe rezultatet e vjetra të testeve .....	24
9.09 Pikëzimi dhe interpretimi .....	25
9.10 Shpjegimi i rezultateve të vlerësimit .....	25
9.11 Ruajtja e sigurisë së testit .....	25
Kreu 10 Terapia .....	25
10.01 Marrja e miratimit të informuar në terapi.....	25
10.02 Terapia që përfshin çiftet ose familjet .....	26
10.03 Terapia në grup/terapia e grupit .....	26
10.04 Ofrimi i terapisë për persona që marrin shërbime nga të tjerë.....	26
10.05 Intimiteti seksual me klientët/pacientët aktualë të terapisë.....	26
10.06 Intimiteti seksual me të afërmit apo persona të tjerë të rëndësishëm të klientëve/pacientëve aktualë në terapi .....	26
10.07 Terapia me ish-partnerë seksualë.....	26
10.08 Intimiteti seksual me ish- klientë/pacientë të terapisë .....	26
10.09 Ndërpërja e terapisë.....	27
10.10 Përfundimi i terapisë.....	27

## Njohja dhe zbatueshmëria

Parimet Etike të Psikologëve dhe Kodi i Etikës dhe Deontologjisë (në vazhdim Kodi i Etikës) i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga një hyrje, një parathënie, pesë parimet e përgjithshme dhe standardet specifike etike. Hyrja përshkruan qëllimin, organizimin, parimet proceduriale dhe fushën e zbatimit të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë. Parathënia dhe parimet e përgjithshme kanë si qëllim që të udhëheqin psikologët drejt idealeve më të larta në fushën e psikologjisë. Edhe pse parathënia dhe parimet e përgjithshme nuk janë vetë rregulla të zbatueshme, ato duhet të mbahen në vëmendje nga psikologët për të garantuar një veprimtari etike. Standardet etike përcaktojnë rregullat e duhura të sjelljes për psikologun. Shumica e standardeve etike janë të përgjithshme, me qëllim që të zbatohen nga psikologët në të gjithë pozicionet ku ushtrojnë detyrën e tyre. Standardet etike nuk janë shteruese. Kodi i Etikës zbatohet në çdo aspekt të ushtrimit të profesionit nga psikologu, ku përfshihen, por pa u kufizuar: psikologji klinike, këshillim psikologjik, psikologji shkollore, kërkim shkencor në psikologji, mësimdhënie, supervizim, shërbime publike, hartim i politikave, ndërhyrje sociale, zhvillim i instrumenteve të vlerësimit, kryerje e vlerësimeve psikologjike, këshillim edukativ, konsulencë organizative, aktivitete ligjore, programe hartuese dhe vlerësimi, dhe administrim. Ky Kod i Etikës zbatohet për këto aktivitete, pavarësisht formës në të cilën kryhen, duke përfshirë: takimet personale ballë për ballë, nëpërmjet postës, telefonit, internetit dhe transmetimeve të tjera elektronike. Për efekt të zbatimit të këtij Kodi bëhet një dallim i qartë i aktivitetit profesional të psikologut me sjelljet krejtësisht private të tij, të cilat nuk i nënshtrohen rregullave të këtij kodi.

Mungesa e njohjes apo keqkuptimi i ndonjë standardi etik nuk është justifikim për një sjellje joetike.

Procedurat për paraqitjen, hetimin dhe zgjidhjen e ankesave për sjellje joetike përcaktohen në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor Profesional. UP mund të vendosë sanksione ndaj anëtarëve të tij për shkelje të standardeve të Kodit të Etikës, duke përfshirë edhe ndërprerjen e anëtarësisë në UP dhe ka të drejtë të njoftojë për masat e marra organe dhe individë të tjerë të interesuar, nëse e gjykon të nevojshme. Veprimet që janë në kundërshtim me standardet e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë mund të sjellin si pasojë vendosjen e sanksioneve edhe nga organe të tjera, përveç UP, duke përfshirë shoqatat e psikologëve, grupe të tjera profesionale, bordet psikologjike, apo agjenci dhe institucione të tjera shtetërore. Kodi i Etikës ka për qëllim të përcaktojë standarde të sjelljes profesionale edhe nga organe të tjera që zgjedhin t'i përvetësojnë ato. Kodi i Etikës nuk ka si qëllim të shërbejë si bazë për gjykimin e përgjegjësive civile apo penale. Konstatimi i shkeljeve të standardeve të Kodit Etik nga Komisioni i Etikës dhe Gjykimit Disiplinor nga një psikolog nuk përcakton detyrimisht se psikologu është ligjërisht përgjegjës edhe në një shqyrtim tjetër gjyqësor.

Termet e përgjithshme të përdorura në disa nga standardet e kodit të etikës (*p.sh. në mënyrë të arsyeshme, i përshtatshëm, potencialisht*) shërbejnë për ato raste kur duhet:

- (1) që psikologu të çmojë vetë veprimin apo mosveprimin që duhet të kryejë,
- (2) të eliminohen pasojat e dëmshme që mund të vijnë nga mosmbajtja në vëmendje e termave të mësipërme,
- (3) të sigurohet zbatueshmëria e standardeve etike pavarësisht llojit të aktivitetit profesional të kryer nga psikologët, si dhe:

(4) të garantohet mbrojtja e standardit nga një grup rregullash të ngurta, të cilat mund të vjetërohen shpejt.

Ashtu siç është përdorur në këtë Kod Etike, termi “i arsyeshëm” nënkupton gjykimin e zakonshëm profesional të psikologëve të angazhuar në aktivitete të ngjashme profesionale, në rrethana të ngjashme, duke patur parasysh njohuritë që psikologu ka pasur ose duhet të ketë patur në atë kohë.

Në procesin e marrjes së vendimeve në lidhje me sjelljen e tyre profesionale, psikologët duhet të zbatojnë këtë Kod Etike, përveç ligjeve të aplikueshme dhe rregulloreve të tjera në fuqi. Në zbatimin e Kodit të Etikës psikologët duhet të mbajnë në vëmendje edhe materiale të tjera udhëzuese, që janë miratuar ose pranuar për zbatim nga organizata psikologjike shkencore dhe profesionale, zërin e ndërgjegjes së tyre, si dhe të konsultohen me ekspertë të tjerë brenda fushës. Nëse ky Kod Etike përcakton një standard më të lartë të sjelljes sesa kërkohet me ligj, psikologët duhet të plotësojnë standardet më të larta etike. Nëse përgjegjësitë etike të psikologëve bien ndesh me ligjin, rregulloret ose ndonjë autoritet tjetër ligjor qeveritar, psikologët bëjnë të ditur angazhimin e tyre sipas këtij Kodi Etike dhe marrin hapa për të zgjidhur konfliktin në një mënyrë të arsyeshme, në përputhje me parimet themelore të të drejtave të njeriut.

### **Parathënie**

Psikologët angazhohen në rritjen e njohurive shkencore dhe profesionale të sjelljes në të kuptuarit e vetes dhe të tjerëve, si dhe në përdorimin e këtyre njohurive në përmirësimin e gjendjes së individëve, organizatave dhe shoqërisë. Psikologët respektojnë dhe mbrojnë të drejtat civile dhe njerëzore, si dhe rëndësinë thelbësore të kërkimit dhe shprehjes së lirë në kërkimin shkencor, mësimdhënie dhe publikime. Ky Kod Etike siguron parime dhe standarde të përbashkëta mbi të cilat psikologët ndërtojnë punën e tyre profesionale dhe shkencore.

Kodi i Etikës ka për qëllim të garantojë mirëqenien dhe mbrojtjen e individëve dhe grupeve me të cilët punojnë psikologët dhe edukimin e anëtarëve, studentëve dhe publikut lidhur me standardet etike të disiplinës së psikologjisë.

Zhvillimi i një grupi dinamik standardesh etike për sjelljen profesionale të psikologëve kërkon një angazhim personal dhe përpjekje të vazhdueshme gjatë gjithë jetës:

- për të vepruar në mënyrë etike;
- për të inkurajuar sjelljen etike te studentët, supervizorët, të punësuarit dhe kolegët;
- për të evidentuar probleme shqetësuese të etikës.

### **Parimet e përgjithshme**

Ky seksion përbëhet nga parimet e përgjithshme. Parimet e përgjithshme, në ndryshim nga standardet etike, kanë natyrë frymëzuese. Qëllimi i tyre është që të drejtojnë dhe frymëzojnë psikologët drejt idealeve më të larta etike të profesionit. Parimet e përgjithshme, ndryshe nga standardet etike, nuk përfaqësojnë detyrime dhe nuk duhet të shërbejnë si bazë për vendosjen e sanksioneve. Përdorimi i tyre për një nga këto qëllime shtrembëron kuptimin e parimeve të përgjithshme.

### **Parimi A: Përfitimi dhe mosdëmtimi**

Psikologët përpiqen që të jenë ndihmues me klientët e tyre dhe të kujdesen që të mos u shkaktojnë dëme. Në veprimet e tyre profesionale psikologët përpiqen të ruajnë mirëqenien

dhe të drejtat e atyre me të cilët ndërveprojnë profesionalisht dhe personave të tjerë të përfshirë, si dhe mirëqenien e kafshëve që janë subjekte të kërkimit shkencor. Kur ndodhin konflikte për shkak të detyrës ose që lidhen me profesionin e psikologut, ai përpiket t'i zgjidhë ato në një mënyrë të përgjegjshme, duke shmangur ose minimizuar dëmin. Për shkak se veprimet dhe gjykimet profesionale dhe shkencore të psikologëve mund të prekin jetën e të tjerëve, ata duhet të jenë të vëmendshëm dhe të përpiqen të parandalojnë që faktorët personalë, financiarë, socialë, organizacionalë dhe politikë të çojnë në keqpërdorimin e ndikimit profesional të tyre. Psikologët përpiqen të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë që ka shëndeti i tyre fizik dhe mendor në aftësinë që kanë për të ndihmuar ata me të cilët punojnë.

### **Parimi B: Besnikëria dhe përgjegjësia**

Psikologët krijojnë marrëdhënie besimi me ata me të cilët punojnë. Ata janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre profesionale dhe shkencore, për shoqërinë dhe për komunitetet e veçanta në të cilat punojnë. Psikologët duhet të respektojnë standardet e sjelljes profesionale, qartësojnë pozicionin e tyre profesional, dhe detyrimet që rrjedhin prej tij, të pranojnë përgjegjësitë përkatëse për sjelljen e tyre dhe të shmangin konfliktet e interesit, që mund të çojnë në përfitime të padrejta apo dëmtime të të tjerëve. Psikologët duhet të konsultohen, t'u referohen ose të bashkëpunojnë me profesionistë dhe institucione të tjera, për t'u shërbyer sa më mirë interesave të atyre me të cilët punojnë.

Psikologët duhet të jenë të vëmendshëm dhe të evidentojnë çdo rast kur konstatojnë sjellje jo etike profesionale apo shkencore të kolegëve të tyre. Psikologët përpiqen të ofrojnë një pjesë të aktivitetit të tyre profesional përkundrejt shpërblimeve minimale apo pa përfitim personal.

### **Parimi C: Integriteti**

Psikologët kanë si qëllim të nxisin saktësinë, ndershmërinë dhe vërtetësinë në shkencë, mësimdhënie dhe në ushtrimin e profesionit të psikologut. Në këto veprimtari psikologët nuk duhet të vjedhin, të mashtrojnë ose të përfshihen në manovra, dredhi apo shtrembërime të qëllimshme të fakteve. Psikologët përpiqen të mbajnë premtimet dhe t'u shmangen angazhimeve të papërgjegjshme ose të paqarta. Përpara se psikologët të zgjedhin të përdorin manipulimin, duhet të vlerësojnë:

- a) Nëse është etikisht i justifikueshëm për të arritur në maksimum rezultatet e shërbimit të ofruar dhe për të minimizuar dëmin,
- b) pasojat e mundshme,
- c) si dhe duhet të marrin përgjegjësinë për minimizimin e efekteve të tjera të dëmshme, që mund të lindin nga përdorimi i teknikave të tilla.

### **Parimi D: Drejtësia**

Ky parim u jep të drejtë të gjithë personave për të përfituar njësoj nga shërbimet e psikologjisë, si dhe të kenë të njëjtën cilësi në proceset, procedurat dhe shërbimet e kryera nga psikologët. Psikologët duhet të jenë të arsyeshëm dhe të marrin masa paraprake për të shmangur praktikat jo të drejta. Për këtë qëllim, duhet të mbajnë në konsideratë kufijtë e kompetencës dhe ekspertizës së tyre.

### **Parimi E: Respekt për dinjitetin dhe të drejtat e njeriut**

Psikologët duhet të respektojnë dinjitetin dhe vlerën e të gjithë njerëzve, të drejtat e individëve për privatësi, konfidencialitet dhe vendimmarrje. Psikologët janë të vetëdijshëm se mund të

nevojiten masa të veçanta mbrojtëse për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e personave ose komuniteteve, kufizimet e të cilëve dëmtojnë vendimmarrjen e tyre autonome. Psikologët janë të vetëdijshëm dhe respektojnë dallimet kulturore, individuale dhe të roleve të caktuara, përfshirë ato të bazuara në moshë, gjini, identitetin gjinor, racë, etnicitet, kulturë, origjinë kombëtare, fe, orientim seksual, paaftësi gjuhësore dhe statusin socio-ekonomik, dhe i mbajnë në vëmendje këta faktorë gjatë punës së tyre me anëtarë të këtyre grupeve. Në punën e tyre, psikologët përpiqen të shmangin efektin e paragjytimeve të bazuara në këta faktorë, dhe, me vetëdije, nuk marrin pjesë ose shmangin aktivitete të bazuara në të tilla paragjykime.

## **Kreu 1: Zgjidhja e çështjeve etike**

### **1.01 Keqpërdorimi i punës së psikologut**

Nëse psikologët vihen në dijeni se puna e tyre është keqpërdorur ose shtrembëruar, ata ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të korrigjuar ose minimizuar keqpërdorimin ose shtrembërimin.

### **1.02 Konfliktet ndërmjet etikës, ligjit, rregulloreve ose një autoriteti tjetër ligjor rregullues**

Nëse përgjegjësitë etike të psikologut janë në konflikt me ligjin, rregulloret ose ndonjë autoritet tjetër ligjor, psikologët duhet të sqarojnë natyrën e konfliktit, duhet të bëjnë të ditur angazhimin e tyre ndaj Kodit të Etikës dhe duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të zgjidhur konfliktin në përputhje me parimet e përgjithshme dhe standardet e Kodit të Etikës. Në asnjë rrethanë nuk mund të përdoret ky standard për të justifikuar apo mbrojtur shkeljen e të drejtave të njeriut.

### **1.03 Konfliktet ndërmjet etikës dhe kërkesave organizative**

Nëse kërkesat e një organizate apo agjencie publike ose private, në të cilën psikologët janë të angazhuar ose për të cilën punojnë, janë në kundërshtim me Kodin e Etikës, psikologët duhet të sqarojnë natyrën e konfliktit, duhet të bëjnë të njohur angazhimin e tyre ndaj Kodit të Etikës dhe duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të zgjidhur konfliktin në përputhje me parimet e përgjithshme dhe standardet e Kodit të Etikës. Në asnjë rrethanë nuk mund të përdoret ky standard për të justifikuar apo mbrojtur shkeljen e të drejtave të njeriut.

### **1.04 Zgjidhja jozyrtare për shkeljet etike**

Kur psikologët konstatojnë se mund të ketë ndodhur një shkelje etike nga një psikolog tjetër dhe zgjidhja jozyrtare është e përshtatshme dhe efikase, ata duhet të përpiqen ta zgjidhin çështjen duke e sjellë atë në vëmendjen e psikologut që ka kryer shkeljen, nëse kjo zgjidhje nuk çënon të drejtën e konfidencialitetit. (*Shih Standardin: 1.02 Konfliktet ndërmjet etikës dhe ligjit, rregulloreve, ose një autoriteti tjetër ligjor rregullues dhe 1.03 Konfliktet ndërmjet etikës dhe kërkesave organizative*).

### **1.05 Raportimi i shkeljeve të etikës**

Nëse një shkelje e dukshme etike ka dëmtuar ndjeshëm ose ka të ngjarë të dëmtojë një person ose një organizatë apo agjenci, publike apo private, dhe zgjidhja jozyrtare (sipas Standardit 1.04), nuk është e përshtatshme, kjo shkelje duhet t'i referohet Komisionit të Etikës dhe Gjyqimit Profesional. (*Shih Standardin 1.02 Konfliktet ndërmjet etikës dhe ligjit, rregulloreve, ose një autoriteti tjetër ligjor rregullues*).



### **1.06 Bashkëpunimi me komisionin e etikës dhe organet e tjera të Urdhrit të Psikologut.**

*(Ndryshuar me Vendimin Nr.5 datë 02.06.2023 të Asamblesë së VII-të Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)*

Psikologët kanë detyrimin të bashkëpunojnë për hetimin e çështjeve që lidhen me shkeljet e etikës, për analizimin dhe nxjerrjen e rezultateve të kërkuara nga UP. Mungesa e bashkëpunimit në vetvete është një shkelje e etikës. Mosrespektimi i rregullave, vendimeve dhe çdo akti tjetër të detyrueshëm për zbatim të dala nga organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut, përbën shkak për nisjen e procedimit disiplinor.

### **1.07 Ankesat e papërshtatshme**

Psikologët nuk duhet të paraqesin ose nxisin paraqitjen e ankesave haptazi të padrejta apo abuzive për shkelje të etikës, ose të cilat mund të bëhen nga vlerësimi i pakujdesshëm ose nga injorimi i qëllimshëm i fakteve që do të hidhnin poshtë pretendimin për shkelje.

### **1.08 Diskriminimi i padrejtë kundrejt ankuesve dhe të paditurve**

Psikologët nuk pengojnë punësimin, zhvillimin, pranimin në programe akademike, apo të tjera, të individëve që kanë bërë apo janë subjekt i një ankese etike. Kjo nuk përjashton marrjen e masave bazuar në rezultatet e procedimeve disiplinore ose mbajtjen në vëmendje të informacioneve të tjera të përshtatshme.

## **Kreu 2: Kompetenca**

*(Ndryshuar me Vendimin Nr.5 datë 02.06.2023 të Asamblesë së VII-të Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)*

### **2.01 Kufijtë e kompetencës**

(a) Psikologët e ushtrojnë aktivitetin profesional vetëm në ato fusha që janë brenda kufijve të kompetencave të tyre, bazuar në lejen e ushtrimit të profesionit, të përfutur dhe akteve ligjore në fuqi. Kufijtë e kompetencës profesionale mund të zgjerohen rast pas rasti, vetëm bazuar në aktet normative të nxjerra nga Urdhri i Psikologut.

(b) Psikologët e ushtrojnë profesionin e tyre në ambiente të përshtatshme për ushtrimin e profesionit. Përveç psikologëve që ushtrojnë profesionin në organizata, institucione publike apo private, psikologu duhet të marrë masa të përshtatshme, që vendi ku ushtron profesionin të sigurojë privatesinë, ruajtjen e konfidencialitetit dhe të jetë në përputhje me llojin e profilit të shërbimit të ofruar. Përveç rasteve të emergjencave apo përveçse kur është në përputhje me qëllimin për të cilin realizohet, psikologu nuk e ushtron aktivitetin e tij në mjedise publike apo jashtë vendit ku ushtron zyrtarisht aktivitetin.

(c) Kur dija profesionale dhe shkencore në disiplinën e psikologjisë përcakton se kuptimi i faktorëve që lidhen me moshën, gjininë, identitetin gjinor, racën, etninë, kulturën, origjinën kombëtare, besimin, orientimin seksual, aftësinë e kufizuar, gjuhën ose statusin socio-ekonomik është thelbësor për zbatimin efektiv të shërbimeve apo kërkimit të tyre, psikologët duhet të trajnohen, të marrin eksperiencë, të marrin konsultime ose supervizim të nevojshëm për të qenë kompetentë në shërbimet që ofrojnë, përveç rasteve të parashikuara në Standardin (2.02 Ofrimi i shërbimeve në kushte emergjence).

(ç) Psikologët që planifikojnë të ofrojnë shërbime, të japin mësim ose të kryejnë kërkime që përfshijnë popullata, fusha, teknika ose teknologji të reja për ta, duhet të marrin edukimin përkatës, trajnimin, supervizionin, eksperiencën, konsultimin apo studimin e nevojshëm.

(d) Kur psikologëve u kërkohet të sigurojnë shërbime për individë, për të cilët shërbimet përkatëse të shëndetit mendor nuk janë të mundshme dhe vetë psikologët nuk kanë kompetencat e nevojshme, me qëllim që të mos u mohohen shërbimet atyre që kanë nevojë, psikologët, që kanë trajnim ose eksperiencë të përafërt, mund të ofrojnë shërbime të tilla, por ata duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të fituar kompetencat e nevojshme nëpërmjet kërkimit, trajnimit, konsultimit ose studimit përkatës.

(e) Kur marrin përsipër misione ligjore, psikologët duhet të jenë në dijeni ose të njihen me rregullat juridike ose administrative që rregullojnë misionin e tyre.

### **2.02 Ofrimi i shërbimeve në kushte emergjence**

Në raste emergjencash, psikologët mund të ofrojnë shërbime për individë, ndaj të cilëve shërbimet e tjera të shëndetit mendor nuk janë të disponueshme, edhe për rastet kur psikologët nuk kanë marrë trajnimin e nevojshëm për këto shërbime. Shërbimet në këtë rast ndërpriten sapo emergjenca të përfundojë ose të mundësohen shërbimet e duhura.

### **2.03 Ruajtja e kompetencave**

Psikologët përpiqen në mënyrë të vazhdueshme për të zhvilluar dhe ruajtur kompetencat e tyre.

### **2.04 Bazat për gjykimet shkencore dhe profesionale**

Puna e psikologut bazohet mbi njohuritë bazë shkencore dhe profesionale të disiplinës së psikologjisë. (*Shih Standardin 2.01e Kufijtë e kompetencës dhe 10.01b Marrja e miratimit të informuar në terapi*).

### **2.05 Delegimi i punës te të tjerët**

*(Ndryshuar me Vendimin Nr.5 datë 02.06.2023 të Asamblesë së VII-të Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)*

Psikologët të cilët delegojnë punën marrin hapa të arsyeshëm:

(1) për të shmangur delegimin e një pune të tillë te persona që kanë konflikt interesi me përfituesit e shërbimit, e cila do të çonte në keqpërdorim ose humbje të objektivitetit;

(2) për të deleguar vetëm ato detyra, që persona të tillë mund të kryejnë, bazuar në edukimin, trajnimin ose eksperiencat e tyre, dhe, që mund të realizohen në mënyrë të pavarur ose me supervizion;

(3) për të kontrolluar nëse këta persona i realizojnë këto shërbime me kompetencë. (*Shih Standardin 2.02 Ofrimi i shërbimeve në kushte emergjence; 3.05 Marrëdhëniet e shumëfishta; 4.01 Mbajtja e konfidencialitetit; 9.01 Bazat për vlerësimet; 9.02 Përdorimi i vlerësimeve; 9.03 Marrja e miratimit të informuar në vlerësim; dhe 9.07 Vlerësimi nga persona të pakualifikuar.*)

### **2.06 Problemet personale dhe konfliktet**

(a) Psikologët e shmangin fillimin e një aktiviteti profesional kur e dinë ose duhet të dinë, se ekziston një mundësi objektivisht e konsiderueshme, që problemet e tyre personale do t'i pengojnë në realizimin e tij në mënyrën e duhur.

(b) Kur psikologët, gjatë kryerjes së një detyre profesionale, bëhen të vetëdijshëm për probleme personale, që mund të ndikojnë në realizimin e duhur të saj, duhet të marrin masa të

përshtatshme, si konsultim ose asistencë profesionale, për të përcaktuar kohën, se kur duhet të kufizojnë, pezullojnë ose ndërpresin detyrën profesionale të nisur. *(Shih Standardin 10.10 Ndërprerja e terapisë)*

### **Kreu 3: Marrëdhëniet njerëzore**

#### **3.01 Diskriminimi i padrejtë**

Në aktivitetin profesional psikologët nuk duhet të përfshihen, drejtpërdrejt apo tërthorazi, në diskriminimin e padrejtë bazuar në moshë, gjini, identitet gjinor, racë, etni, kulturë, kombësi, besim, orientim seksual, paaftësi, status socio-ekonomik ose çdo çështje tjetër të ndaluar me ligj.

#### **3.02 Ngacmimi seksual**

Psikologët nuk duhet të përfshihen në ngacmime seksuale. Ngacmim seksual quhet joshja seksuale, ngacmimi fizik ose verbal, si dhe sjellja jo verbale me natyrë seksuale, e kryer gjatë veprimtarisë psikologjike ose në rolin si psikolog dhe që:

(1) është e padëshirueshme, fyese ose krijon një mjedis pune ose edukimi të papërshtatshëm, për të cilin psikologu është ose duhet të jetë i vetëdijshëm

(2) është mjaftueshëm e rëndë ose intensive për të qenë abuzive. Ngacmimi seksual mund të konsistojë në një veprim të vetëm të rëndë ose në veprime të shumta, të qëndrueshme ose të kryera në forma të ndryshme. *(Shih Standardin 1.08 Diskriminimi i padrejtë përkundrejt ankuesve dhe të paditurve)*

#### **3.03 Ngacmime të tjera**

Psikologët nuk duhet të përfshihen në sjellje, që janë ngacmuese dhe poshtëruese për individët me të cilët ndërveprojnë gjatë punës së tyre, duke u bazuar në faktorë si moshë, gjinia, identiteti gjinor, raca, etnia, kultura, kombësia, besimi, orientimi seksual, paaftësia, gjuha dhe statusi socio-ekonomik i këtyre individëve.

#### **3.04 Shmangia e dëmtimit**

(a) Psikologët duhet të marrin masa të arsyeshme për të shmangur dëmtimin e klientëve/pacientëve, studentëve, supervizorëve, pjesëmarrësve në kërkime shkencore, klientëve në organizata dhe individëve të tjerë me të cilët punojnë si edhe për të minimizuar dëmtimin, kur ky i fundit është i paparashikueshëm dhe i pashmangshëm.

(b) Psikologët duhet të shmangin në çdo rast çdo veprim, që mund të shkaktojë në mënyrë të qëllimshme të një individ dhimbje dhe vuajtje, fizike ose mendore, apo çdo lloj veprimi, që mund të cilësohet si sjellje mizore, çnjerëzore, dhunuese dhe degraduese

#### **3.05 Marrëdhëniet e shumëfishta**

(a) Një marrëdhënie konsiderohet e shumëfishtë, kur një psikolog ka një detyrim profesional kundrejt një personi dhe, në të njëjtën kohë, ka një marrëdhënie tjetër të afërt me të njëjtin person apo me një person të afërt të tij, edhe kur kjo marrëdhënie pritet që të krijohet në të ardhmen.

Psikologët i shmangen krijimit të marrëdhënies së shumëfishtë vetëm në rastet, kur kjo marrëdhënie mund të shkaktojë dëmtimin e objektivitetit, kompetencës ose efikasitetin e psikologut në kryerjen e rolit të tij si psikolog, ose rrezikon keqpërdorimin apo dëmtimin e personit tjetër.

Marrëdhëniet e shumëfishta që nuk shkaktojnë dëmtim, keqpërdorim ose pasoja të dëmshme për palët, nuk janë joetike.

(b) Nëse psikologu zbulon se, për shkak të faktorëve të papritur, është ndërtuar një marrëdhënie e dëmshme, merr masa të arsyeshme për ta zgjidhur, duke u mbështetur tek interesi më i mirë i personit të prekur dhe në përputhje maksimale me Kodin e Etikës.

c) Kur psikologu, për shkak të ligjit, politikave institucionale apo rrethanave të jashtëzakonshme, përfshihet në një marrëdhënie të shumëfishtë, është i detyruar të qartësojë pozicionin e tij për të gjitha palët, si dhe kufijtë e respektimit të parimit të konfidencialitetit. *(Shih Standardin 3.04 Shmangia e dëmtimit dhe 3.07 Kërkesa për shërbim nga palët e treta).*

### **3.06 Konflikti i interesit**

Psikologët refuzojnë marrjen e një detyrimi profesional, kur interesat personale, shkencore, profesionale, ligjore, financiare, familjare ose marrëdhënie të tjera, mund të ndikojnë në objektivitetin apo efikasitetin e kryerjes së këtij detyrimi.

### **3.07 Kërkesa për shërbim nga palët e treta**

Kur psikologët pranojnë t'i ofrojnë shërbim një individ ose grup individësh me kërkesë nga palët e treta, duhet të qartësojnë, në fillim të shërbimit, natyrën e marrëdhënies me të gjithë palët e përfshira. Ky qartësim përfshin rolin e psikologut (p.sh. terapist, këshillues, diagnostikues ose dëshmitar ekspert), identifikimin e klientit, përdorimet e mundshme të shërbimeve të ofruara ose informacionit të marrë, dhe faktin se mund të ketë kufizim të konfidencialitetit. *(Shih Standardin 3.05 Marrëdhëniet e shumëfishta dhe 4.02 Diskutimi i kufizimeve të konfidencialitetit)*

### **3.08 Marrëdhëniet shfrytëzuese**

Psikologët nuk duhet t'i shfrytëzojnë personat të cilët ata mbikëqyrin, vlerësojnë ose kanë autoritet tjetër mbi ta, të tillë si klientët/pacientët, studentët, të supervizuarit, pjesëmarrësit në hulumtime dhe të punësuarit. *(Shih Standardin 3.05 Marrëdhëniet e shumëfishta; 6.04 Tarifat dhe marrëveshjet financiare; 6.05 Shkëmbimet klering me klientët/pacientët; 7.07 Marrëdhëniet seksuale me studentët dhe personat nën supervizim; 10.05 Intimiteti seksual me klientët/pacientët aktualë të terapisë; 10.06 Intimitetit seksual me të afërmit apo të tjerë të rëndësishëm të klientëve/pacientëve aktualë në terapi; 10.07 Terapia me ish-partnerë seksualë; 10.08 Intimiteti seksual me ish- klientë/pacientë të terapisë).*

### **3.09 Bashkëpunimi me profesionistë të tjerë**

Kur është e rekomandueshme dhe profesionalisht e përshtatshme, psikologët duhet të bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë, me qëllim që t'u shërbejnë klientëve/pacientëve të tyre efektivisht dhe në mënyrë të përshtatshme. *(Shih Standardin 4.05 Zbulimi i informacioneve identifikuese).*

### **3.10 Miratimi i informuar**

(a) Kur psikologët bëjnë kërkime, vlerësime, terapi, këshillim dhe shërbime konsultimi, në çfarëdolloj forme, sigurohen, që këto janë bërë me miratimin e informuar të individëve që u nënshtrohen këtyre shërbimeve, përveçse kur, kryerja e aktiviteteve të tilla pa pëlqim, është e autorizuar me ligj, akte nënligjore, vendim të organeve ligjzbatuese ose kur parashikohet

ndryshe në këtë Kod të Etikës. (*Shih Standardin 8.02 Miratimi i informuar për kërkimin shkencor; 9.03 Marrja e miratimit të informuar në vlerësim; 10.01 Marrja e miratimit të informuar në terapi*).

(b) Për personat që janë ligjërisht të paaftë për të dhënë miratimin, psikologët në çdo rast mbajnë parasysh interesin më të lartë të individit dhe, nëse është e mundur, sigurojnë miratimin e informuar nga personi i autorizuar ligjërisht. Kur miratimi i personit të autorizuar ligjërisht nuk është i lejuar ose nuk kërkohet nga ligji, psikologët marrin hapa të arsyeshëm për të mbrojtur të drejtat dhe mirëqenien e individit. (*Shih Standardin 8.02 Miratimi i informuar për kërkimin shkencor; 9.03 Marrja e miratimit të informuar në vlerësim; 10.01 Marrja e miratimit të informuar në terapi*).

(c) Kur shërbimet psikologjike janë të urdhëruara nga gjykata ose janë të mandatuara nga organe të tjera ligjzbatuese, psikologu informon individin për natyrën e shërbimit të parashikuar dhe për çdo kufizim të konfidencialitetit, përpara se të procedohet.

(d) Psikologu dokumenton miratimin e informuar në një formë të përshtatshme.

### **3.11 Shërbimet psikologjike për organizatat ose nëpërmjet organizatave**

(a) Psikologët që ofrojnë shërbime për organizatat ose nëpërmjet organizatave fillimisht u japin informacion klientëve dhe, kur është e nevojshme, atyre që preken direkt nga shërbimet për:

- (1) natyrën dhe objektivat e shërbimeve,
- (2) marrësit e synuar të shërbimeve,
- (3) individualizimin e klientëve,
- (4) marrëdhënien që psikologu do të ketë me çdo person dhe organizatë,
- (5) përdorimet e mundshme të shërbimeve të ofruara dhe informacioneve të marra,
- (6) kush do të ketë akses në informacione,
- (7) kufizimet e konfidencialitetit.

Ata duhet të japin informacion në lidhje me rezultatet dhe përfundimet e këtyre shërbimeve te personat e duhur sa më shpejt të jetë e mundur.

(b) Në qoftë se psikologët përjashtohen nga detyrimi ligjor ose nga rolet organizative për dhënien e informacioneve për individë apo grupe të caktuara, ata duhet t'i informojnë këta individë apo grupe që në fillim të shërbimit.

### **3.12 Ndërprerja e shërbimit psikologjik**

Përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në ligj apo në kontratën me përfituesin e shërbimit, psikologët bëjnë përpjekje të arsyeshme për të minimizuar pasojat e ndërprerjes së shërbimit. (*Shih Standardin 6.02 c Mirëmbajtja, shpërndarja dhe asgjësimi i të dhënave konfidenciale të punës profesionale dhe shkencore*).

## **Kreu 4: Konfidencialiteti dhe privatësia**

### **4.01 Ruajtja e konfidencialitetit**

Psikologët kanë detyrimin të marrin masa të nevojshme për të mbrojtur informacionin konfidencial të siguar në çfarëdo lloj mënyre, duke pranuar kufizimet e konfidencialitetit që rregullohen nga ligji, nga rregullat institucionale apo marrëdhëniet profesionale/shkencore. (*Shih Standardin 2.05 Delegimi i punës te të tjerët*.)

#### **4.02 Njoftimi për kufizimet e konfidencialitetit**

(a) Psikologët njoftojnë individët (përfshirë, për aq sa është e mundur, edhe personat të cilët janë ligjërisht të paafitë për të dhënë miratimin e informuar dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë) dhe organizatat me të cilët ata kanë marrëdhënie profesionale për:

(1) kufizimet përkatëse të konfidencialitetit,

(2) mënyrën e përdorimit të informacionit të siguruar përmes aktiviteteve të tyre psikologjike.

(b) Përveç rasteve kur është e mundshme ose është e dëmshme, diskutimi për konfidencialitetin ndodh në fillim të marrëdhënies ose sa më shpejt që ta lejojnë rrethanat.

(c) Psikologët, të cilët ofrojnë shërbime, produkte, apo informacion nëpërmjet transmetimit elektronik, duhet të informojnë përfituesit e shërbimeve për rreziqet e cënimit të privatësisë dhe kufizimet e konfidencialitetit. (*Shih Standardin 3.10 Miratimi i informuar*).

#### **4.03 Regjistrimi**

Përpara se të regjistrojnë zërin ose imazhin e individëve, të cilëve iu ofrojnë shërbim, psikologët duhet të marrin miratimin nga të gjithë këta individë ose nga përfaqësuesit e tyre ligjorë. (*Shih Standardin 8.03 Miratimi i informuar për regjistrimin e zërave dhe imazheve në studime, 8.05 Shpërndarja e informacionit të studimit pas miratimit të informuar, 8.07 Manipulimi në kërkimin shkencor*).

#### **4.04 Minimizimi i ndërhyrjes në privatësi**

Psikologët përfshijnë në raportet e shkruara, apo në ato me gojë, vetëm informacione të rëndësishme, në përshtatje me qëllimin për të cilin është bërë raporti.

Psikologët e përdorin informacionin konfidencial të siguruar gjatë punës së tyre vetëm për qëllime profesionale dhe shkencore dhe vetëm me individë të interesuar për këtë çështje.

#### **4.05 Zbulimi i informacioneve identifikuese**

Psikologët mund të bëjnë publike informacione konfidenciale, vetëm me një miratim të përshtatshëm të institucioneve, të individëve përfitues të shërbimit ose nga një person tjetër i autorizuar me ligj, përveçse nëse është e ndaluar me ligj.

Psikologët zbulojnë informacione konfidenciale pa miratimin e individit, vetëm nëse është e kërkuar nga ligji ose, nëse e lejon ligji për qëllime të vlefshme si:

(1) sigurimi i shërbimit profesional të nevojshëm;

(2) sigurimi i konsultimit profesional të përshtatshëm;

(3) mbrojtja e klientit/pacientit, psikologut ose e të tjerëve nga dëmtimi; ose

(4) sigurimi i pagesës për shërbimin nga përfituesi i shërbimit, në rastet kur informacioni i zbuluar kufizohet në minimumin e nevojshëm për të arritur qëllimin. (*Shih Standardin 6.04e Tarifat dhe marrëveshjet financiare*).

#### **4.06 Konsultimet**

Kur konsultohen me kolegët e tyre, psikologët nuk duhet të zbulojnë informacione konfidenciale që, në mënyrë të arsyeshme, mund të çojnë në identifikimin e klientit/pacientit, pjesëmarrësit në kërkime shkencore ose e personave të tjerë dhe organizatave, me të cilët ata kanë një marrëdhënie besimi, përveçse kur kanë marrë pëlqim paraprak, dhe, kur ata zbulojnë aq informacion sa është i nevojshëm për të arritur qëllimin e konsultimit. (*Shih Standardin 4.01 Ruajtja e konfidencialiteti*.)

#### **4.07 Përdorimi i informacioneve konfidenciale për qëllime didaktike ose për qëllime të tjera.**

Psikologët nuk zbulojnë në publikimet e tyre, leksionet ose në media, informacione konfidenciale ose informacione personale që ndikojnë në identifikimin e klientëve/pacientëve të tyre, studentëve, pjesëmarrësve në kërkime shkencore, klientëve të organizatave ose marrësve të tjerë të shërbimeve gjatë punës së tyre, përveç rasteve kur:

- (1) ato nuk identifikojnë personin ose organizatën,
- (2) personi ose organizata kanë dhënë miratim me shkrim, ose
- (3) ka një autorizim ligjor për ta bërë këtë.

### **Kreu 5: Reklama dhe deklarata të tjera publike**

#### **5.01 Shmangia e deklaratave të pavërteta ose keqorientuese**

(a) Deklaratat publike përfshijnë, por nuk kufizohen, në reklamim të paguar apo të papaguar, përkrahje të produktit, aplikime për grante, aplikime për liçencim, aplikime të tjera për kualifikime, broshura, materiale të shtypura, lista, përmbledhje personale, curriculum vitae, apo komente për përdorim në media të tilla si: shtypi ose transmetime elektronike, deklarata për procedura ligjore, ligjërime dhe prezantime gojore publike, si dhe materiale të publikuara. Psikologët nuk duhet të bëjnë në mënyrë të qëllimshme deklarata publike të rreme, keqorientuese apo mashtruese, në lidhje me studimin, praktikën ose aktivitetet e tjera të punës së tyre, apo të personave ose organizatave në të cilat janë të anëtarësuar.

(b) Psikologët nuk duhet të bëjnë deklarata të rreme, keqorientuese apo mashtruese, në lidhje me:

- (1) trajnimin, përvojën, ose aftësitë e tyre;
  - (2) gradën akademike;
  - (3) kredencialet;
  - (4) antarësimet në institucione ose shoqata;
  - (5) shërbimet që ofrojnë;
  - (6) bazën klinike ose shkencore të shërbimeve të tyre ose rezultatet dhe shkallën e suksesit të shërbimeve që ofrojnë;
  - (7) tarifat;
  - (8) botimet apo rezultatet e hulumtimeve të tyre.
- (c) Psikologët i paraqesin gradat e tyre si kredenciale për shërbimet që ata ofrojnë, vetëm nëse këto grada:

- (1) janë përfituar nga një institucion edukimi rajonal i akredituar ose
- (2) përbëjnë kriter për liçencimin e psikologut në shtetin ku praktikojnë profesionin.

#### **5.02 Deklarata nga të tjerë**

(a) Psikologët të cilët përfshijnë persona të tjerë për të bërë deklarata publike, që promovojnë praktikën e tyre profesionale, produktet apo aktivitetet e tyre, mbajnë përgjegjësi profesionale për këto deklarata.

(b) Psikologët nuk duhet të japin shpërblime për punonjësit e shtypit, radios, televizionit, ose për ndonjë media tjetër, me qëllim paraqitjen e reklamës si lajm. (*Shih Standardin 1.01 Keqpërdorimi i punës së psikologut*).

(c) Reklama e paguar në lidhje me aktivitetet e psikologëve duhet të identifikohet ose të kuptohet qartësisht si e tillë.

### **5.03 Përshkrimi i kurseve dhe programeve të edukimit që nuk ofrojnë grada**

Psikologët përgjegjës për njoftime, katalogë, broshura ose përshkrimin e trajnimeve, seminareve apo programeve edukuese, që nuk ofrojnë grada, duhet të sigurohen që kanë përshkruar me saktësi audiencën, për të cilën është hartuar programi, objektivat edukative, prezantuesit, dhe tarifat e përfshira.

### **5.04 Prezantimet në media**

Kur psikologët japin këshilla publike, apo komentojnë nëpërmjet shtypit, internetit ose transmetimeve të tjera elektronike, ata marrin paraprakisht masa për të siguruar se deklaratat e tyre:

- (1) bazohen në njohuritë e tyre profesionale, trajnimet ose përvojën në përputhje me praktikën dhe literaturën psikologjike;
- (2) janë në përputhje me këtë Kod të Etikës, dhe,
- (3) nuk sugjerojnë vendosjen e një marrëdhënieje profesionale me publikun, të cilit i drejtohen. (*Shih Standardin 2.04 Bazat për gjykimin shkencor dhe profesional*).

### **5.05 Dëshmitarët**

Psikologët nuk i nxisin, apo nuk u kërkojnë të japin dëshmi klientëve/pacientëve, që janë aktualisht në terapi, si dhe personave të tjerë, të cilët, për shkak të rrethanave të veçanta, janë të cënueshëm nga presione të pajustificuara.

### **5.06 Kërkesat personale**

Psikologët nuk kërkojnë vetë ose përmes agjentëve, për të punuar me klientë/pacientë potencialë (ose me persona të tjerë, të cilët për shkak të rrethanave të veçanta, janë të cënueshëm nga presioni i tepërt), nëse këto kërkesa nuk vijnë nga vetë personat.

Ky ndalim nuk përjashton:

- (1) rastet kur kjo gjë bëhet për të mirën e klientit/pacientit aktual në terapi;
- (2) ndërhyrjet në raste fatkeqësish ose ndërhyrjet në terren në komunitet.

### **5.07 Komunikime të tjera publike**

*(Shtohet me Vendimin Nr.5 datë 02.06.2023 të Asamblesë së VII-të Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)*

Çdo psikolog duhet të tregohet i kujdesshëm në komunikimin publik, nëpërmjet deklaratave apo mesazheve publike, në mënyrë që më deklaratat e tij të mos cenojë, denigrojë, apo të prishë imazhin dhe punën e një kolegu tjetër psikolog, institucionit, apo profesionit në tërësi.

## **Kreu 6: Mirëmbajtja e të dhënave dhe tarifimi**

### **6.01 Dokumentimi i punës shkencore dhe profesionale dhe mirëmbajtja e të dhënave**

Psikologu duhet të administrojë të dhënat që lidhen me punën e tij profesionale dhe shkencore në mënyrë që:

- (1) të lehtësojë ofrimin e shërbimeve të mëvonshme nga ana e tij ose nga profesionistë të tjerë,



- (2) të mundësojë përsëritjen e kërkimeve dhe analizave shkencore,
  - (3) të përmbushë kërkesat institucionale,
  - (4) të sigurojë përpikmëri në faturim dhe pagesa, dhe
  - (5) të sigurojë përputhshmërinë me ligjin.
- (Shih Standardin 4.01 Ruajtja e konfidencialitetit).

### **6.02 Mirëmbajtja, shpërndarja dhe asgjësimi i të dhënave konfidenciale të punës profesionale dhe shkencore**

- (a) Psikologët sigurojnë mbrojtjen e të dhënave personale në krijimin, ruajtjen, aksesin, transferimin dhe asgjësimin e të dhënave nën kontrollin e tyre, si në rastet kur këto të dhëna janë të shkruara, të automatizuara, apo të ruajtura në ndonjë formë tjetër. (Shih Standardin 4.01 Ruajtja e konfidencialitetit dhe 6.01 Dokumentimi i punës shkencore dhe profesionale dhe mbajtja e shënimeve).
- (b) Nëse informacioni konfidencial që lidhet me marrësit e shërbimeve psikologjike, regjistrohet në *database* apo sisteme regjistrimi të aksesueshme nga persona, të cilëve nuk u është dhënë leja nga marrësi i shërbimit, psikologët duhet të përdorin kodimin, apo teknika të tjera për të shmangur identifikimin.
- (c) Psikologët marrin hapa paraprake me qëllim lehtësimin e transferimit të përshtatshëm dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave, në rastet kur ndërpresin për çfarëdolloj arsye shërbimin profesional. (Shih Standardin 3.12 Ndërprerja e shërbimit psikologjik dhe 10.09 Ndërprerja e terapisë).

### **6.03 Refuzimi i dhënies së informacionit për shkak të moskryerjes së pagesës**

Psikologët nuk duhet të refuzojnë të japin dokumentacionin, që kanë nën kontroll, kur kërkohet për nevojat e trajtimit emergjent të një klienti/pacienti, vetëm sepse nuk është kryer ende pagesa.

### **6.04 Tarifat dhe marrëveshjet financiare**

- (a) Në një marrëdhënie profesionale apo shkencore, sa më herët të jetë e mundur, psikologët dhe përfituesit e shërbimeve psikologjike duhet të arrijnë një dakordësi për masën e shpërblimit dhe mënyrën e kryerjes së pagesës.
- (b) Tarifat e shërbimeve psikologjike duhet të jenë në përputhje me ligjin, nëse ky i fundit përcakton tarifa ligjore.
- (c) Psikologët nuk duhet të bëjnë tarifime të rreme.
- (d) Nëse ligji parashikon paraprakisht kufizime në shërbime për shkak të kufizimeve në pagesa, ato duhet t'i bëhen të ditura, sa më parë të jetë e mundur, përfituesit të shërbimeve. (Shih Standardin 10.09 Ndërprerja e terapisë dhe 10.10 Përfundimi i terapisë).
- (e) Nëse pranuesi i shërbimeve nuk paguan për shërbimet, siç është rënë dakord, dhe, në qoftë se psikologu ka ndërmend të përdorë masat ligjore për të mbledhur detyrimet financiare të faturuara, psikologu fillimisht duhet të informojë përfituesin e shërbimeve në lidhje me këto masa dhe t'i japë mundësinë për të kryer pagesën në mënyrë të menjëhershme e të shpejtë. (Shih Standardin 4.05 Zbulimi i informacioneve identifikuese; 6.03, Refuzimi i dhënies së informacionit për shkak të moskryerjes së pagesës; 10.01 Marrja e miratimit të informuar në terapi).

### **6.05 Shkëmbimet klering me klientët/pacientët**

Shkëmbimi klering është pranimi i mallrave, produkteve, apo shpërblimit jomonetar nga klientët/pacientët në këmbim të shërbimeve psikologjike.

Psikologët mund përdorin *kleringun* vetëm nëse:

(1) nuk është e kundërlinduar klinikisht,

(2) marrëveshja nuk është me natyrë shfrytëzuese. (*Shih Standardin 3.05 Marrëdhëniet e shumëfishta dhe 6.04 Tarifat dhe marrëveshjet financiare*).

### **6.06 Përpikmëria në raportet ndaj pagesit dhe burimeve të financimit**

Në raportet e tyre për pagesit e shërbimeve ose burimeve të financimit për kërkimin shkencor, psikologët përpiqen të raportojnë saktë mbi natyrën e shërbimit të ofruar ose kërkimin e kryer, tarifat, detyrimet, dhe pagesat, dhe atëherë kur është e mundur, identitetin e ofruesit, gjetjet dhe diagnozat. (*Shih Standardin 4.01 Ruajtja e konfidencialitetit; 4.04 Minimizimi i ndërhyrjes në privatësi dhe 4.05 Zbulimi i informacioneve identifikuese*).

### **6.07 Referimet dhe tarifat**

Kur psikologët paguajnë, marrin pagesa, apo ndajnë tarifat me një profesionist tjetër në kushte të ndryshme nga marrëdhënia punëmarrës-punëdhënës, pagesa ndaj secilit bazohet në llojin e shërbimit të ofruar (klinik, konsultues, administrativ, etj.). (*Shih Standardin 3.09 Bashkëpunimi me profesionistë të tjerë*).

## **Kreu 7: Edukimi dhe trajnimi**

### **7.01 Hartimi i programeve të edukimit dhe trajnimit**

Psikologët përgjegjës për programet edukuese dhe trajnuese përpiqen që programet të hartohen në mënyrë të tillë, që të ofrojnë njohuritë e përshtatshme, përvojën e duhur dhe të jenë në përputhje me kriteret e licencimit, certifikimit apo qëllime të tjera të reklamuar nga programi. (*Shih Standardin 5.03 Përshkrimi i kurseve dhe programeve të edukimit që nuk ofrojnë grada*).

### **7.02 Përshkrimi i programit të edukimit dhe trajnimit**

Psikologët përgjegjës për programet arsimore dhe trajnuese përpiqen të ofrojnë një përshkrim të saktë të përmbajtjes së programit (përfshirë pjesëmarrjen në kurset e detyrueshme, apo këshillimin, psikoterapinë, grupet e eksperiencës, projektet konsultuese apo shërbimin në komunitet, që lidhen me programin e trajnimit), qëllimeve dhe objektivave të trajnimit, bursat dhe përfitimet si dhe kriteret që duhen përbushur për përfundimin me sukses të programit. Ky informacion duhet t'u vihet në dispozicion të gjitha palëve të interesuara.

### **7.03 Saktësia në mësimdhënie**

(a) Psikologët përpiqen që programet mësimore të kurseve që hartojnë, të jenë të saktë në lidhje me përmbajtjen, mënyrën e vlerësimit dhe pritshmëritë nga ky program mësimor.

Ky standard nuk përjashton modifikimin e përmbajtjes apo kriterëve, kur:

- çmohet e nevojshme nga ana pedagogjike,

- studentët janë informuar për këto modifikime,

- nuk e bën të pamundur përbushjen e kriterëve të kursit.

(*Shih Standardin 5.01 Shmangia e deklaratave të pavërteta ose keqorientuese*).

(b) Kur përfshihen në mësimdhënie apo trajnime, psikologët i paraqesin informacionet psikologjike me përpikëri. (*Shih Standardin 2.03 Ruajtja e kompetencave*).

#### **7.04 Zbulimi i informacionit personal të studentit**

Psikologët nuk u kërkojnë studentëve të zbulojnë informacione personale në kurs apo aktivitete që lidhen me programin që ata ndjekin, qoftë verbalisht apo me shkrim, për sa i përket historisë seksuale, historisë së abuzimit apo neglizhimit, trajtimit psikologjik dhe marrëdhënies me prindërit, bashkëmoshatarët, bashkëshortët, me përjashtim të rasteve kur:

- (1) programi apo objekti i trajnimit e ka indentifikuar qartësisht këtë si kriter pranimi, apo material i programit,
- (2) informacioni është i nevojshëm për të vlerësuar apo ofruar asistencë për studentët, problemet personale të të cilëve mund të gjykohen se pengojnë performancën e tyre,
- (3) në rastet ku paraqesin rrezik për veten, apo të tjerët.

#### **7.05 Terapia e detyrueshme individuale ose në grup**

(a) Kur terapia individuale ose në grup është një kërkesë e programit mësimor, studentëve u jepet mundësia për ta kryer këtë terapi me profesionistë, që nuk janë të lidhur direkt me programin. (*Shih Standardin 7.02 Përshkrimi i programit të edukimit dhe trajnimit.*)

(b) Fakulteti, që është ose ka të ngjarë të jetë përgjegjës për vlerësimin akademik të studentëve, nuk e ofron këtë terapi. (*Shih Standardin 3.05 Marrëdhëniet e shumëfishta*).

#### **7.06 Vlerësimi i performancës së studentëve dhe të personave nën supervizim**

(a) Në marrëdhëniet akademike dhe supervizuese, psikologët u japin *feedback* në mënyrë të strukturuar studentëve dhe personave nën supervizim. Informacioni, në lidhje me këtë proces, jepet që në fillim.

(b) Psikologët i vlerësojnë studentët dhe personat nën supervizim në bazë të performancës së tyre aktuale në përputhje me kriteret e vendosura në program.

#### **7.07 Marrëdhëniet seksuale me studentët dhe personat nën supervizim**

Psikologët nuk përfshihen në marrëdhënie seksuale me studentët, apo persona nën supervizim, të cilët janë në departamentin e tyre, agjencinë, qendrën e trajnimit ose, mbi të cilët, psikologët kanë ose kanë të ngjarë të kenë pushtet vlerësues.

### **Kreu 8: Kërkimet dhe publikimet**

#### **8.01 Miratimi institucional**

Kur për një kërkim shkencor nevojitet një miratim institucional, psikologët japin informacion të saktë në lidhje me propozimet e tyre për kërkimin shkencor dhe marrin miratimin paraprak për kryerjen e tij. Ata e kryejnë kërkimin në përputhje me protokollin e miratuar të studimit.

#### **8.02 Miratimi i informuar për kërkimin shkencor**

(a) Kur marrin miratimin e informuar, siç kërkohet në Standardin 3.10, psikologët informojnë pjesëmarrësit për:

- (1) qëllimin e studimit, kohëzgjatjen, dhe procedurat;
- (2) të drejtën e tyre për të marrë pjesë dhe për tu tërhequr nga studimi pasi ka filluar pjesëmarrja në studim;
- (3) pasojat e parashikuara nga tërheqja ose largimi;
- (4) faktorët e arsyeshëm të parashikuar që mund të priten të ndikojnë në vullnetin e tyre për të marrë pjesë, të tilla si: rreziqet e mundshme, paretaria, ose efekte negative;
- (5) të gjitha përfitimet e mundshme nga studimi;

- (6) kufizimet e konfidencialitetit;
- (7) stimujt/shpërblimet për pjesëmarrje;
- (8) personat e kontaktit për pyetjet në lidhje me studimin dhe të drejtat e pjesëmarrësve në studim. Psikologët ofrojnë mundësi për pjesëmarrësit në kërkim që të bëjnë pyetje dhe të marrin përgjigje.

*(Shiko Standardin 8.03 Miratimi i informuar për regjistrimin e zërave dhe imazheve në studim; 8.05 Shpërndarja e informacionit të studimit pas miratimit të informuar; 8.07 Manipulimi në kërkimin shkencor).*

(b) Psikologët, që drejtojnë kërkime për përdorimin e trajtimeve eksperimentale, duhet të sqarojnë pjesëmarrësit në fillim të studimit për:

- (1) natyrën eksperimentale të studimit;
- (2) shërbimet, që do të jenë ose jo të disponueshme në grupin e kontrollit;
- (3) mënyrat, përmes të cilave do të bëhet trajtimi dhe do të caktohet grupi i kontrollit;
- (4) alternativa të tjera të disponueshme, në rast se një individ nuk dëshiron të marrë pjesë më në studim apo dëshiron të tërhiqet, pasi ka filluar studimi dhe;
- (5) kompesimet për shpenzimet monetare të pjesëmarrjes, duke përfshirë, nëse është e përshatshme, rimbursimin për pjesëmarrësit. *(Shih Standardin 8.02a Miratimi i informuar për kërkimin shkencor).*

### **8.03 Miratimi i informuar për regjistrimin e zërave dhe imazheve në studim**

Psikologët marrin miratimin e informuar nga pjesëmarrësit në studim, përpara se të fillojnë me regjistrimin e zërit dhe imazhit të tyre, përveç rasteve kur:

- (1) studimi konsiston vetëm në vëzhgimin natyral në vende publike dhe nuk është parashikuar që regjistrimi do të përdoret në një mënyrë që mund të shkaktojë identifikimin e personit ose dëmtimin e tij,
- (2) formati i studimit parashikon marrjen e miratimit për përdorimin e regjistrimit gjatë mbledhjes së shkëmbimit të informacionit. *(Shih Standardin 8.07 Manipulimi në kërkimin shkencor).*

### **8.04 Klientët/pacientët, studentët dhe vartësit, si pjesëmarrës në studim**

(a) Kur psikologët kryejnë studime, ku pjesëmarrës janë klientët/pacientët, studentët ose vartësit e tyre, ata marrin masa për të mbrojtur pjesëmarrësit e mundshëm nga pasojat negative, në rast të ndërprerjes, apo dorëheqjes nga pjesëmarrja.

(b) Kur pjesëmarrja në studim është një kërkesë e programit mësimor ose një mundësi për kredite shtesë, pjesëmarrësve të mundshëm u jepet mundësia të zgjedhin aktivitete alternative të barazvlershme.

### **8.05 Shpërndarja e informacionit të studimit pas miratimit të informuar**

Psikologët mund të shpërndajnë informacion, duke marrë miratimin e informuar, vetëm nëse :

- (1) studimi nuk supozohet të krijojë stres ose dëme dhe përfshin:
  - (a) studimin e praktikave normale të edukimit, kurrikulën, ose metodat e menaxhimit të kryera në mjediset arsimore ;
  - (b) vetëm pyetësorë anonimë, vëzhgime natyrale, ose kërkime arkivore, për të cilat zbulimi i përgjigjeve nuk do t'i vendoste pjesëmarrësit në rrezik të përgjegjësishë penale ose civile ose

dëmtojnë financat e tyre, punësimin apo reputacionin, dhe, kur konfidencialiteti është i mbrojtur;

(c) studimin e faktorëve, që lidhen me punën apo efektivitetin e organizatës, të kryer në rrethana organizacionale, në të cilat pjesëmarrësit nuk rrezikojnë punësimin dhe ku ruhet konfidencialiteti;

(2) kur lejohet nga ligji ose rregullat institucionale.

### **8.06 Ofrimi i stimujve për pjesëmarrje në studim**

(a) Psikologët bëjnë përpjekje të arsyeshme për të shmangur ofrimin e shpërblimeve financiare të tepërta dhe të papërshtatshme apo stimujve të tjerë për pjesëmarrjen në kërkim, në rastet kur stimuj të tillë rrisin gjasat për një pjesëmarrje të sforcuar.

(b) Kur ofrojnë shërbime profesionale si një stimul pjesëmarrjeje në studim, psikologët sqarojnë natyrën e shërbimeve, si dhe rreziqet, detyrimet dhe kufizimet. (*Shih Standardin 6.05 Shkëmbimet klering me klientët/pacientët*).

### **8.07 Manipulimi në kërkimin shkencor**

(a) Psikologët nuk kryejnë një studim, që përfshin praktika manipuluese, nëse nuk kanë përcaktuar qartë se përdorimi i teknikave të tilla justifikohet nga perspektiva domethënëse shkencore, edukuese apo vlerës së aplikuar të studimit, dhe, se procedurat alternative, që nuk përfshijnë manipulimin, nuk janë të realizueshme.

(b) Psikologët nuk i manipulojnë pjesëmarrësit e ardhshëm në kërkim, në rastet kur manipulimi priret të shkaktojë dhimbje fizike, apo forma të ndryshme distresi të fortë emocional.

(c) Psikologët u shpjegojnë pjesëmarrësve, sa më shpejt të jetë e mundur, çdo praktikë manipuluese, që është pjesë integrale e studimit dhe e kryerjes së një eksperimenti, mundësisht deri në përfundim të pjesëmarrjes së tyre, por jo më vonë se në përfundim të mbledhjes së të dhënave dhe u japin mundësi pjesëmarrësve të tërheqin të dhënat e tyre. (*Shih Standardin 8.08 Informimi*).

### **8.08 Informimi**

(a) Psikologët u japin mundësi pjesëmarrësve që të marrin informacionin e duhur në lidhje me natyrën, rezultatet dhe përfundimet e studimit dhe ndërmarrin hapat e arsyeshëm për të korrigjuar ndonjë keqkuptim, që pjesëmarrësit mund të kenë, dhe për të cilin psikologët janë të vetëdijshëm.

(b) Në qoftë se vlerat shkencore apo humane justifikojnë vonesat apo mbajtjen e informacionit, psikologët marrin masa të arsyeshme për të zvogëluar rrezikun e dëmtimit.

(c) Kur psikologët bëhen të vetëdijshëm se procedurat kërkimore kanë dëmtuar një pjesëmarrës, ata marrin hapa të arsyeshme për të minimizuar dëmin.

### **8.09 Kujdesi njerëzor dhe përdorimi i kafshëve në studim**

(a) Psikologët marrin, kujdesen dhe përdorin kafshët, në përputhje me ligjet aktuale shtetërore, si dhe standardet profesionale.

### **8.10 Raportimi i të dhënave të studimit**

(a) Psikologët nuk fabrikojnë të dhëna. (*Shih Standardin 5.01a Shmangia e deklaratave të pavërteta ose keqorientuese*).

(b) Nëse psikologët zbulojnë gabime të rëndësishme në të dhënat e publikuara, ata duhet të tregohen të përgjegjshëm për të korrigjuar gabimet.

### **8.11 Plagjiatura**

Psikologët nuk paraqesin si punë të tyre të dhëna apo pjesë nga puna e dikujt tjetër, edhe nëse puna tjetër ose burimi i të dhënave është cituar në mënyrë rastësore.

### **8.12 Merita e publikimit**

(a) Psikologët mbajnë përgjegjësi dhe merita, duke përfshirë edhe meritat e autorësisë, vetëm për punime, në të cilat kanë punuar ose, në të cilat kanë kontribuar në mënyrë domethënëse. (*Shih gjithashtu Standardin 8.12.b*).

(b) Në një publikim duhet të pasqyrohet saktësisht kontributi shkencor dhe profesional i të gjithë individëve të përfshirë, pavarësisht statusit të tyre. Zotërimi i një pozicioni institucional, i tillë si përgjegjës departamenti, nuk justifikon meritën e autorësisë. Kontribute të vogla në kërkim shkencor, apo në shkrime e publikime bëhen të ditura në mënyrë të përshtatshme, si për shembull, me shënime në fund të faqes ose në një deklaratë hyrëse.

(c) Një student listohet si autor kryesor në një artikull me shumë autorë, kur ky botim është i bazuar kryesisht në punimin e doktoratës së studentit ose në rrethana të jashtëzakonshme. Meritat e publikimit diskutohen me studentët, sa më shpejt të jetë e mundur, përgjatë kërkimit dhe procesit të publikimit, sipas rastit. (*Shih Standardin 8.12b Merita e publikimit*).

### **8.13 Publikimi i dyfishtë i të dhënave**

Psikologët nuk publikojnë si të dhëna origjinale, të dhëna që janë publikuar më parë. Kjo nuk përjashton ribotimin e të dhënave, kur ato janë të shoqëruara me shënimet e duhura sqaruese.

### **8.14 Ndarja/dhënia/dorëzimi i të dhënave kërkimore për verifikim**

(a) Pasi të dhënat e studimit janë publikuar, psikologët nuk i fshehin nga profesionistët e tjerë kompetentë të dhënat në të cilat janë bazuar, konkluzionet e arritura, në rastet kur kërkohet të verifikohen pohimet kryesore nëpërmjet rianalizës, dhe, vetëm në rast se të dhënat përdoren vetëm për këtë arsye, me kusht që konfidencialiteti i pjesëmarrësve të ruhet. Shpenzimet, që lidhen me dhënien e një informacioni të tillë, i ngarkohen kërkuesve.

(b) Psikologët, që kërkojnë të dhëna prej psikologëve të tjerë, për të verifikuar gjetjet nëpërmjet rianalizës, mund t'i përdorin të dhënat vetëm për qëllimin e deklaruar. Psikologët, të cilëve u kërkohen të dhënat, marrin një marrëveshje paraprake me shkrim për të gjitha përdorimet e tjera të të dhënave.

### **8.15 Rishikuesit/Shqyrtuesit/Recensentët**

Psikologët, të cilët shqyrtojnë materialin e parashtruar për prezantim, publikim, grante apo rishikim të projektit kërkimor, respektojnë konfidencialitetin dhe të drejtat e autorit.

## **Kreu 9: Vlerësimi**

### **9.01 Bazat e vlerësimit**

(a) Psikologët i bazojnë opinionet e paraqitura në rekomandimet, raportet, diagnostikimet ose deklaratat vlerësuese, duke përfshirë edhe vlerësimet ligjore, mbi informacione dhe teknika të mjaftueshme për të mbështetur gjetjet e tyre. Psikologët përdorin si baza të vlerësimit vetëm instrumente të standardizuara, përveç rasteve kur vlerësimi kërkohet pikërisht për efekt të

standardizimit. Në çdo rast, psikologët duhet të bëjnë të qartë kufizimet e përdorimit të opinioneve, për shkak të limiteve të standardizimit. (*Shih Standardin 2.04 Bazat për gjykimet shkencore dhe profesionale*).

(b) Përveç rasteve të përshkruara në Standardin 9.01c, psikologët japin opinione për karakteristikat psikologjike të individit, vetëm pasi kanë kryer ekzaminimin e përshtatshëm për të mbështetur deklaratën ose konkluzionin e tyre. Kur, me gjithë përpjekjet e arsyeshme, një ekzaminim i tillë nuk është i mundshëm, psikologët dokumentojnë përpjekjet që kanë bërë dhe rezultatet e këtyre përpjekjeve, sqarojnë ndikimin e mundshëm të këtij kufizimi mbi besueshmërinë dhe vlefshmërinë e opinionit të tyre, dhe në mënyrë të përshtatshme kufizojnë shtrirjen e konkluzioneve apo rekomandimeve të tyre. (*Shih Standardin 2.01 Kufijtë e kompetencës dhe 9.06 Interpretimi i rezultateve të vlerësimit*).

(c) Kur ekzaminimi i individit nuk është i detyrueshëm apo i nevojshëm dhe psikologët e bazojnë vlerësimin në dokumentacionin ose informacionet e marra gjatë supervizimit, psikologët i pasqyrojnë burimet e informacionit, mbi të cilat ata kanë bazuar konkluzionet dhe rekomandimet e tyre.

### **9.02 Përdorimi i vlerësimeve**

(a) Psikologët administrojnë, përshtasin, llogarisin, interpretojnë ose përdorin teknikat vlerësuese, intervistat, testet ose instrumentet, në një mënyrë të tillë dhe për qëllime, që janë të mbështetura nga kërkimi shkencor ose mbështeten në të dhëna, të cilat sugjerojnë vlefshmërinë dhe përdorimin e duhur të teknikave.

(b) Psikologët përdorin instrumente vlerësimi, vlefshmëria dhe besueshmëria e të cilave janë verifikuar për përdorim në popullata specifike. Kur besueshmëria dhe vlefshmëria nuk janë testuar, psikologët përshkruajnë pikat e forta dhe kufizimet e rezultateve të testimit dhe interpretimit.

(c) Psikologët përshtasin metodat e vlerësimit, me preferencat dhe nivelin e njohjes gjuhësore të një individi, përveç rasteve kur përdorimi i një gjuhe alternative është i rëndësishëm për çështjet e vlerësimit.

### **9.03 Marrja e miratimit të informuar në vlerësim**

(a) Psikologët marrin miratimin e informuar për vlerësimin, mjetet e vlerësimit, ose shërbimet diagnostikuese, siç përshkruhet në Standardin 3.10, me përjashtim të rasteve kur:

(1) Testimi është i mandatuar me ligj ose rregullorë;

(2) Miratimi është i nënkuptuar, për shkak se testimi kryhet si një aktivitet rutinë arsimor, institucional, organizativ (p.sh., kur pjesëmarrësit, vullnetarisht, bien dakord me vlerësimin, kur aplikojnë për një punë);

(3) Një nga qëllimet e testimit është të vlerësojë aftësinë vendimmarrëse.

Miratimi i informuar përfshin shpjegimin e natyrës dhe qëllimit të vlerësimit, tarifat, përfshirjen e palëve të treta, kufizimet e konfidencialitetit si dhe mundësitë e mjaftueshme për klientin/pacientin për të bërë pyetje dhe për të marrë përgjigje.

(b) Psikologët informojnë personat, kapaciti i të cilëve për të dhënë miratimin është i diskutueshëm ose personat, vlerësimi i të cilëve është i autorizuar me ligj ose akte nënligjore, në lidhje me natyrën dhe qëllimin e shërbimeve të propozuara të vlerësimit, duke përdorur një gjuhë, që është e kuptueshme për personin që është në vlerësim.

(c) Kur është e nevojshme prania e përkthyesit, psikologët marrin miratimin e informuar nga klienti/pacienti, sigurojnë ruajtjen e konfidencialitetit dhe përfshijnë në rekomandimet, raportet dhe paraqitjen e vlerësimeve apo diagnostikimeve të tyre edhe kufizimet e ardhura nga përkthimi në të dhënat e marra. (*Shih Standardin 2.05 Delegimi i punës te të tjerët; 4.01 Ruajtja e konfidencialitetit; 9.01 Bazat e vlerësimit; 9.06 Interpretimi i rezultateve të vlerësimit dhe 9.07 Vlerësimi nga persona të pakualifikuar*).

#### **9.04 Nxjerrja e të dhënave të testit**

Termi ‘të dhëna të testit’ i referohet të dhënave të papërpunuara dhe të pikëzuara të përgjigjeve të klientit/pacientit ndaj stimulit apo pyetjeve të testit dhe shënimeve e regjistrimeve të psikologut në lidhje me deklaratimet dhe sjelljen e klientit/pacientit gjatë vlerësimit. Përkufizimi i të dhënave të testit përfshin ato pjesë të materialit të testit, që lidhen me përgjigjet e klientit/pacientit. Në përputhje me deklaratën e klientit/pacientit, psikologu i jep të dhënat e testit klientit/pacientit ose personave të tjerë të përcaktuar në deklaratë.

(a) Psikologët mund të mos i nxjerrin të dhënat e testit, me qëllim mbrojtjen e klientit/pacientit, apo personave të tjerë nga një dëmtim serioz, keqpërdorim apo keqinterpretim i të dhënave ose testit. (*Shih Standardin 9.11 Ruajtja e sigurisë së testit*.)

(b) Në mungesë të një deklaratë të lëshuar nga klienti/pacienti, psikologët lëshojnë të dhënat e testit vetëm nëse kërkohet me urdhër nga gjykata.

#### **9.05 Ndërtimi i testit**

Psikologët, të cilët hartojnë teste ose teknika të tjera vlerësimi, përdorin procedura të përshtatshme psikometrike dhe duhet të kenë njohuri shkencore dhe profesionale për të ndërtuar testin, standardizuar, vlerësuar, reduktuar ose eliminuar anshmëritë dhe të japin udhëzimet për përdorim.

#### **9.06 Interpretimi i rezultateve të vlerësimit**

Kur interpretojnë rezultatet e vlerësimit, përfshirë interpretimet e automatizuara, psikologët marrin parasysh qëllimin e vlerësimit dhe, po ashtu, faktorë të ndryshëm të testit, aftësitë për kryerjen e testimit dhe karakteristika të tjera të personit, që do të vlerësohet, të tilla si dallimet rrethanore, personale, gjuhësore dhe kulturore, që mund të ndikojnë gjykimet e psikologut ose të reduktojnë saktësinë e interpretimit të tyre. Ata paraqesin çdo kufizim të mundshëm të interpretimit të tyre. (*Shih Standardin 2.01b dhe c Kufijtë e kompetencës dhe 3.01 Diskriminimi i padrejtë*).

#### **9.07 Vlerësimi nga persona të pakualifikuar**

Psikologët nuk nxisin përdorimin e teknikave të vlerësimit psikologjik nga persona të pakualifikuar, përveçse kur një përdorim i tillë kryhet për qëllime të trajnimit me mbikëqyrje të duhur. (*Shih Standardin 2.05 Delegimi i punës te të tjerët*).

#### **9.08 Testet e vjetëruara dhe rezultatet e vjetra të testeve**

(a) Psikologët nuk i bazojnë vlerësimet, vendimet ndërhyrëse ose rekomandimet në të dhëna ose rezultate testesh, që janë të vjetra në raport me qëllimin aktual.

(b) Psikologët nuk bazojnë vendimet ose rekomandimet në teste ose instrumente, që janë të vjetëruara dhe të padobishme për qëllimin aktual.



### **9.09 Pikëzimi dhe interpretimi**

(a) Psikologët, që ofrojnë vlerësim apo shërbime pikëzimi për profesionistë të tjerë, përshkruajnë me saktësi qëllimin, normat, vlefshmërinë, besueshmërinë, aplikimin e procedurave dhe çdo kualifikim të veçantë, të nevojshëm për përdorimin e tyre.

(b) Psikologët zgjedhin shërbimet e pikëzimit dhe interpretimit (përfshirë shërbimet e automatizuara), duke u bazuar në të dhëna që dëshmojnë vlefshmërinë e programit dhe procedurave, po ashtu edhe konsiderata të tjera të rëndësishme. (*Shih Standardin 2.01b dhe c Kufijtë e kompetencës*).

(c) Psikologët mbajnë përgjegjësi për aplikimin e përshtatshëm, interpretimin dhe përdorimin e instrumenteve të vlerësimit si në rastet kur ata vetë pikëzojnë dhe interpretojnë teste të tilla, ashtu edhe kur përdorin shërbime të tjera të automatizuara.

### **9.10 Shpjegimi i rezultateve të vlerësimit**

Pavarësisht nëse pikëzimi dhe interpretimi është bërë nga psikologët, punonjësit/asistentët, nga shërbime të automatizuara apo shërbime të tjera të jashtme, psikologët marrin masa të sigurojnë se shpjegimet e rezultateve u jepen individëve ose përfaqësuesve të caktuar, përveç rasteve kur natyra e marrëdhënies pengon dhënien e tyre dhe ky fakt i është shpjeguar qartësisht, që në fillim, personit, që është vlerësuar.

### **9.11 Ruajtja e sigurisë së testit**

Termi “materialet e testit” i referohet manualit, instrumenteve, protokollit, pyetjeve të testit dhe nuk përfshin të dhënat e testit siç përcaktohet në Standardin 9.04. Psikologët bëjnë përpjekje të arsyeshme për të ruajtur integritetin dhe sigurinë e materialeve të testit dhe të teknikave të tjera vlerësuese në përputhje me ligjin dhe detyrimet kontraktuale, dhe, në një mënyrë të tillë, që lejon respektimin e këtij Kodi të Etikës.

## **Kreu 10: Terapia**

### **10.01 Marrja e miratimit të informuar në terapi**

(a) Kur marrin miratimin e informuar për terapinë, ashtu siç përcaktohet në Standardin 3.10, psikologët informojnë, sa më shpejt të jetë e mundur, klientët/pacientët në marrëdhënie terapeutike rreth natyrës dhe parashikimit të ecurisë së terapisë, tarifave, përfshirjes së palëve të treta, dhe kufizimet e konfidencialitetit dhe i ofrojnë klientit/pacientit mundësi të mjaftueshme për të bërë pyetje dhe për të marrë përgjigje. (*Shih Standardin 4.02 Diskutimi i kufizimeve të konfidencialitetit dhe 6.04 Tarifat dhe marrëveshjet financiare*).

(b) Kur marrin miratimin e informuar për trajtimin, procedurat dhe teknikat e të cilit ende nuk janë të përcaktuara, psikologët informojnë klientët/pacientët e tyre për natyrën në zhvillim të trajtimit, rreziqet potenciale, trajtimet alternative, që mund të jenë në dispozicion dhe natyrën vullnetare të pjesëmarrjes së tyre. (*Shih Standardin 2.01e Kufijtë e kompetencës dhe 3.10 Miratimi i informuar*).

(c) Kur terapisti është në trajnim dhe përgjegjësia ligjore për trajtimin bie mbi supervizorin, procedura e miratimit të informuar përfshin informimin e klientit/pacientit se terapisti është në trajnim, dhe, se është në proces supervizimi, duke dhënë emrin e supervizorit.

### **10.02 Terapia që përfshin çiftet ose familjet**

(a) Kur psikologët bien dakord për të ofruar shërbime për persona të cilët kanë një marrëdhënie të caktuar (të tilla si të bashkëshortëve ose prindërit dhe fëmijët), ata marrin hapat e arsyeshëm për të sqaruar në fillim:

(1) cili nga personat është klienti/pacienti;

(2) marrëdhënien që psikologu do të ketë me secilin person.

Ky sqarim përfshin rolin e psikologut dhe përdorimet e mundshme të shërbimeve që ofrohen ose informacioneve që merren. (*Shih Standardin 4.02 Diskutimi i kufizimeve të konfidencialitetit*).

(b) Nëse konstatohet se psikologut i kërkohet të kryejë role potencialisht konfliktuale (p.sh. terapist i familjes dhe pastaj dëshmitar për një nga palët në procedurat e divorcit), ai qartëson pozicionin e vet dhe i duhet të heqë dorë nga këto role në mënyrën më të përshtatshme. (*Shih Standardin 3.05.c Marrëdhëniet e shumëfishta*).

### **10.03 Terapia në grup/terapia e grupit**

Kur psikologët ofrojnë shërbime për disa persona në grup, ata i përshkruajnë që në fillim rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira dhe kufizimet e konfidencialitetit.

### **10.04 Ofrimi i terapisë për persona që marrin shërbime nga të tjerë**

Gjatë kohës që vendosin nëse do të ofrojnë shërbime për persona, të cilët ndërkohë marrin shërbime të shëndetit mendor në vende të tjera, psikologët trajtojnë me kujdes çështjet e mirëqenies së klientit/pacientit potencial. Psikologët i diskutojnë këto çështje me klientin/pacientin apo me përfaqësuesin ligjor të klientit/pacientit, në mënyrë që të minimizojnë rrezikun e paqartësive dhe konfliktit, konsultohen me ofruesit e tjerë të shërbimeve, kur është e nevojshme dhe procedojnë me kujdes dhe ndjeshmëri ndaj çështjeve terapeutike.

### **10.05 Intimiteti seksual me klientët/pacientët aktualë në terapi**

Psikologët nuk përfshihen në intimitete seksuale me pacientë/klientë aktualë në terapi.

### **10.06 Intimitetit seksual me të afërmit apo të tjerë të rëndësishëm të klientëve/pacientëve aktualë në terapi**

Psikologët nuk përfshihen në intimitete seksuale me individë që janë të afërm të ngushtë, kujdestarë, apo të afërm të tjerë të klientëve/pacientëve aktualë. Psikologët nuk e përfundojnë terapinë, me qëllim anashkalimin e këtij standardi.

### **10.07 Terapia me ish-partnerë seksualë**

Psikologët nuk pranojnë si klientë/pacientë terapie persona, me të cilët kanë qenë të përfshirë në intimitete seksuale.

### **10.08 Intimiteti seksual me ish- klientë/pacientë të terapisë**

(a) Psikologët nuk përfshihen në intimitet seksual me ish-klientë/pacientë për të paktën dy vite pas ndërprerjes ose përfundimit të terapisë.

(b) Psikologët nuk përfshihen në intimitete seksuale me ish-klientë/pacientë edhe pas një intervali prej 2 vitesh, me përjashtim të rrethanave shumë të pazakonta. Psikologët, që përfshihen në aktivitete të tilla pas 2 vitesh që është ndërprerë, apo ka përfunduar terapia, dhe, të cilët nuk kanë pasur ndërkohë kontakt seksual me ish-klientin/pacientin, mbartin

përgjegjësinë për të dëshmuar se nuk ka pasur marrëdhënie shfrytëzimi, në dritën e gjithë faktorëve të rëndësishëm, duke përfshirë:

- (1) Sasinë e kohës, që ka kaluar që nga përfundimi i terapisë;
- (2) Natyrën, kohëzgjatjen dhe intensitetin e terapisë;
- (3) Rrethanat e përfundimit të terapisë;
- (4) Historinë personale të klientit/pacientit;
- (5) Statusin mendor aktual të klientit/pacientit;
- (6) Mundësinë e ndikimit negativ tek klienti/pacienti;
- (7) Ekzistencën e pohimeve apo veprimeve të bëra nga terapisti gjatë ecurisë së terapisë, që nxisin mundësinë e një marrëdhënieje romantike apo seksuale pas përfundimit të terapisë.

#### **10.09 Ndërprerja e terapisë**

Kur punësohen apo hyjnë në marrëdhënie kontraktuale, psikologët bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar zgjidhjen e rregullt dhe të duhur të përgjegjësisë për klientin/pacientin, në rast se punësimi ose marrëdhënia kontraktuale përfundon, duke i dhënë përparësi mirëqenies së klientit/pacientit. (*Shih Standardin 3.12 Ndërprerja e shërbimit psikologjik*).

#### **10.10 Përfundimi i terapisë**

- (a) Psikologët përfundojnë terapinë kur bëhet krejtësisht e qartë se klienti/pacienti nuk ka më nevojë për shërbimin, nuk ka gjasa të përfitojë prej tij, apo po dëmtohet nga shërbimi i vazhduar.
- (b) Psikologët mund të përfundojnë terapinë, kur kërcënohen apo rrezikohen nga klienti/pacienti, apo ndonjë person tjetër me të cilin klienti/pacienti ka marrëdhënie.
- (c) Me përjashtim të rasteve kur pengohet nga veprimet e klientëve/pacientëve apo palëve të treta paguese, përpara përfundimit të terapisë, psikologët ofrojnë këshillim përmbyllës dhe sugjerojnë shërbime alternative sipas nevojës.

---

**Miratuar me vendimin nr.1, datë 30.06.2017 të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë.**